



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:285256

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06587679

C.nr.1248/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen kontestimore të paditëses R. S., nga fshati Ll. e E., K. e D., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M. B., avokate në D., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Besart Cacaj, Avokat Publik Komunal, me objekt kontesti kompensimi i orëve mbinormë, me vlerë të kontestit 208.23 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses R. S., me anë të të cilës ka kërkuar që të *“APROVOHET kërkesëpadia e paditëses R. S., dhe të OBLIGOHET e paditura Komuna e Deçanit - Drejtoria e Arsimit që paditëses në emër të kompensimit për orët mbi normë, për vitin shkollor 2020-2021, për gjithsej 33 orë, duke i llogaritur rritje të pagës 30 %, të ia paguajë shumën prej 6,31 euro për çdo orë mbi normë, apo për 33 orë mbi normë, shumën e përgjithshme prej 208,23 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe të DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104,00 euro, për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë shumën prej 104,00 euro dhe për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, e deri në pagesë definitive”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës të saj, më datë 15.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, për kompensimin e orëve mësimore mbinormë, me vlerë të kontestit 208.23 euro. Në padi dhe precizim të kërkesëpadisë të datës 15.10.2024 ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse në Sh.F.M.U “K... i V.... të Ll.”, në fshatin Ll. e E., K. e D me normë të plotë 40 orë punë në javë, 20 orë mësimore në javë, me pagë bazë 481,98 euro dhe e njëjta në bazë të kalendarit të planifikimit të orëve me lëndë zgjedhore ka mbajtur orë mbi normë dhe përkundër obligimit të të paditurës lidhur me pagesën e pagave të orëve mbi normë, nuk e ka

paguar asnjëherë paditësen, andaj me padi ka kërkuar që të detyrohet e paditura në emër të orëve mbi normë për vitin shkollor 2020-2021, për 33 orë mbi normë, t'ia paguaj paditëses shumë prej 208.23 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga paraqitja e padisë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 23.10.2024 e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë e paditëses për shkak të parashkrimit, mosekzistimit të bazës juridike, mungesës së provave. Fillimisht thekson se Drejtoria Komunale e Arsimit nuk ka bërë kërkesë më shkrim tek mësimdhënësja të punojë mbi normë sipas padisë dhe se shkolla ka qenë e obliguar të bëjë sistemimin e orëve sipas kontratës së punës. Me Ligjin e Punës neni 28 paragrafi 1, Rregulloren QRK nr. 07/2022 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik, neni 8 dhe Rregulloren QRK nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik neni 8, përcaktohet qartë se vetëm me kërkesën e institucionit zyrtari publik duhet të punoj jashtë orarit dhe në rastin konkret DKA asnjëherë nuk ka bërë kërkesë me shkrim për punë shtesë të paditëses, andaj ka propozuar që padia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK- së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, pas pranimit të përgjigjes në padi, duke u nisur nga fakti se, e drejta apo detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është e karakterit absolut, dhe në rrethana të caktuara mund të mos kërkohej mbajtja e një seance publike gjyqësore. Lidhur me këtë aspekt të procedurës, GJEDNJ në rastin Jussila v. Findland (Aktgjykimi i dt. 23 nëntor 2006, paragrafi 41), ka përcaktuar se, “*Detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është absolut. Pra, ekzistojnë rrethana që nuk kërkojnë mbajtjen e një seance gjyqësore publike, dhe atë p.sh., kur nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestuara mes palëve dhe që determinojnë mbajtjen e një seance gjyqësore, andaj, gjykata mund të vendos në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme lidhur me çështjen në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara.*” Gjykata duke marr parasysh këtë, vendosjen në këtë mënyrë e bazoj duke i nisur nga natyra jo komplekse e çështjes si dhe duke u bazuar në nenin 399 paragrafi 1 të LPK i cili parasheh se: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.*”

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes paditëses dhe të paditurës nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës të lidhur në mes paditëses dhe të paditurës dhe se e njëjta ka normë të plotë të punës prej 20 orë në javë (neni dy i kontratës), pjesë e shkresave të lëndës.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Sh.F.M.U “K... i V.... të Ll.”, nr.01/1520 datë 13.12.2023, vërtetohet se paditësja për periudhën, apo vitin shkollor 2021-2022 ka gjithsej 33 orë mbi normë.

MASHT, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin para universitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar orarin e punës për mësimdhënës, konkretisht me datë 06.11.2015 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 17/2015 për Orët e Punës së Personelit të Punësuar në Institucionet që i Zbatojnë Programet për Arsim dhe Aftësim Profesional.

Në nenin 1 të këtij udhëzimi përcaktohet se “ *Me këtë Udhëzim adminsitrativ, përcaktohen orët e punës së personelit mësimor në institucione që i zbatojnë programet për arsim dhe aftësim profesional si dhe kohëzgjatja e orëve mësimore të lëndëve teorike dhe moduleve praktike.*” Tutje, sipas nenit 2 par. 1 tek përkufizimet, IAAP – nënkupton *Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional*”.

Në nenin 3 të këtij udhëzimi përcaktohet se “*orët e punë së personelit mësimor, ku në nenin 1 përcaktohet se Orët e punës së personelit mësimor IAAP, janë 40 orë në javë e të cilat i përfshijnë par.2 Punët profesionale të drejtpërdrejta në procesin edukativo – arsimor dhe 3. Punë të tjera të cilat burojnë drejtpërdrejtë nga procesi edukativo – arsimor dhe aftësimi.*” Udhëzimi në fjalë, në nenin 4 ka përcaktuar orët e punës së mësimdhënësve drejtpërdrejt të angazhuar në procesin mësimor në IAAP, ashtu që në par.2 “*për mësimdhënësit e lëndëve të përgjithshme, 20 orë mësimore në javë, par.3 për mësimdhënësit e lëndëve teorike profesionale, 20 orë mësimore në javë, kurse në paragrafin 7 parashihet se si ndërliohen punët teorike me atë praktike, konkretisht raportit në mes të këtyre dy punëve kur kombinohen së bashku, ashtu që “ Teori: Praktikë 20:24, ose 1:1.2. Nëse numri i orëve mësimore të lëndëve teorike është X, numri i orëve të moduleve praktike Y, atëherë orët e plotë të punës janë $X+(Y \times 1,2)$ orë në javë*”.

Në nenin 5 të të njëjtit Udhëzim, përcaktohet orari i plotës i punës së mësimdhënësve, ku “*Orët e punës së plotë të mësimdhënësve konsiderohet fondi i orëve të caktuara sipas nenit 3 dhe 4*”.

Krejt në fund të kësaj, në nenin 7 është përcaktuar se për çdo orë shtesë mbi normë, personeli i IAAP i angazhuar drejtpërdrejtë në procesin mësimor dhe administrativ teknik, paguhet për orë mësimore shtesë sipas legjislativit në fuqi.

Në një interpretim sistematik dhe logjik të këtyre dispozitave ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi, orët e punës për mësimdhënësit, në përgjithësi janë 40 orë në javë, sepse llogariten së bashku orët sipas nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit. Pra, nuk janë dhe nuk mund të interpretohen në mënyrë të shkëputur nga njëra tjetra, orët e punës dhe orët mësimore, sepse orët e punës, i ngërthejnë në vete orët mësimore. Pra norma e orëve prej 20 orë në javë, është në kuadër orëve të punës prej 40 orë në javë. Kjo do të thotë se, paditësja edhe pse ka punuar orë mbi normën e paraparë, të njëjtat i ka në kuadër të orëve të punës, pasi që edhe sipas Ligjit të Punës, sipas nenit 20 par. 2, orari i plotë i punës, zgjat dyzet orë në javë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Pretendimet e palës paditëse, se e njëjta ka punuar punë shtesë, andaj i takon kompensimi sipas nenit 56 të Ligjit të Punës, për 30 % të pagës bazë të saj, gjykata sqaron se e njëjta nuk ka punuar punë shtesë, mirëpo orët e punës i ka mbajtur brenda orarit të rregullt të punës, e jo jashtë orarit të përcaktuar prej 8 orë në ditë apo 40 orë në javë.

Pavarësisht krejt kësaj, gjykata e ka marrë në tërësi të bazuar pretendimin e palës së paditur, se paditësja nuk ka ofruar asnjë dëshmi, se e njëjta orët e punës mbi normë, i ka bërë sipas ndonjë vendimi nga DKA, sepse sipas Udhëzimit Administrativ nr. 10/2015 për Kontratën e Punës për Mësimdhënësit të Arsimit Parauniversitar, nenit 6 të këtij Udhëzimi, është përcaktuar se *“në rast të ndryshimit të fondit të orëve të punës apo mësimin në procesin edukativo arsimor, do të lidhet kontratë e re”*. Kjo do të thotë se ligjvënësi e ka paraparë mënyrë se si të veprohet për orët e punës mbi normë, që do të thotë se nëse DKA si organ kompetent, nëse ka vlerësuar se duhet që paditësja të punojë mbi normën e caktuar, është dashur që të bëjë ndryshimin e kontratës së lidhur me paditësen dhe të përcaktojë numrin e saktë të orëve mbi normë apo edhe të orëve shtesë, ashtu siç i është referuar paditësja.

Për gjykatën, në mënyrë se si ka vepruar paditësja, është e paqartë se mbi çfarë baze ligjore e njëjta ka punuar “orë” mbi normën e paraparë me kontratë, sepse është fakt i njohur se kontrata është ligj për palët, kurse çdo punë tjetër jashtë kushteve të përcaktuar me kontratë, ligj apo udhëzim, duhet të përcaktohet në mes të palëve kontraktuale, e jo që në mënyrë të njëanshme njëra palë të ndërmarrë veprime, e më pastaj të kërkojë kompensim në emër të orëve shtesë. Sipas nenit 3 par. 1.11 të Ligjit të Punës, përcaktohet se *“Kontrata e Punës - akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit,*

Për këtë arsye, ligjvënësi ka paraparë që nëse duhet që i punësuarit të punojë për orë mbi normën e përcaktuar, atëherë duhet që të lidhet kontrata e re e punës, apo të ketë një vendim nga punëdhënësi që e obligon paditësen për punë mbi normë, apo edhe punë shtesë, e jo që në mënyrë të njëanshme, njëra palë të ndërmarrë veprime, siç ka bërë paditësja, pa asnjë bazë ligjore.

Nga të lartcekurat, gjykata konstaton se pretendimi i palës paditëse për kompensimin e pagës shtesë për shkak të orëve të punës mbi normë është në tërësi i pa bazuar, për arsye se orët e punës për paditësen si në kontratën e saj të punës dhe Udhëzimin Administrativ 17/2015 për Orët e Punës së Personelit të Punësuar në Institucionet që i Zbatojnë Programet për Arsim dhe Aftësim Profesional janë përcaktuara, ku paditësja si mësimdhënëse, sipas kontratës se punës se saj ka pasur të përcaktuara 40 orë punë e prej tyre 20 orë mësimi në javë, andaj paditësja me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se e njëjta ka punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA.nr.17/2015 dhe në kontratën e saj të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit, sepse paditësja me punën e realizuar mbi normë, nuk ka punuar orë shtesë, por e njëjta ka punuar brenda orarit të saj të punës dhe ka zbatuar vetëm obligimet e saja të përcaktuara nga kontrata e punës. Po ashtu, në funksion të kësaj, edhe pse e njëjta ka punuar me orë mbi normën e caktuar, sërish të njëjtës nuk i lind e drejta për kompensim, sepse kur ka vepruar në mënyrë të tillë, ka vepruar në kundërshtim me kontratën e saj të punës që ka të lidhur me të paditurën dhe nuk ka pas një obligim të tillë që të veprojë në këtë mënyrë, e as që i është kërkuar nga pala e paditur, por në mënyrë të njëanshme ka ndërmarrë veprime për punë mbi normë.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse, e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadiinë e paditëses si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale, u mor sipas nenit 450 të LPK, meqë pala paditëse ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar të njëjtat.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin, 143.1 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Dega në Deçan,
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1248/23, datë 12.12.2024

Gj y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.